

GZ.: 048101/2021-0003

Graz, më 15. Korrik 2021

Zgjedhjet e Këshillit Bashkiak, e Këshillave të Lagjeve dhe e Këshillit të Imigranteve/-ëve në Graz, 2021

Njoftim

- (1) Zgjedhjet e Këshillit Bashkiak të Graz-it do të mbahen të dielën, më 26 shtatorë 2021. Data 16 korrik 2021 vlen si datë referencë, pra si data e përcaktimit të të dhënave mbi të cilat do të zhvillohen këto zgjedhje.

Për Këshillin Bashkiak do të zgjidhen 48 anëtarë.

Të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhjet e Këshillit Bashkiak e kanë të gjithë burrat dhe gratë, të cilët:

- kanë mbushur moshën 16 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve;
- në datën e referencës rezultojnë të kenë një shtetësi të një shteti anëtar të Bashkimit Europian;
- nuk janë përjashtuar nga e drejta e votës;
- kanë vendbanimin e përhershëm në zonën e qytetit.

Të drejtën për t'u zgjedhur në Këshillin Bashkiak e kanë të gjithë burrat dhe gratë me të drejtën e votës, të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën kur zhvillohen zgjedhjet. Nënshetasit e Bashkimit Europian, të cilët nuk kanë nënshetësi austriake, mund të zgjidhen vetëm atëherë, nëse ata paraqesin një dokument të organit kompetent përkatës të shtetit prej nga vijnë, sipas të cilit vërtetohet, se personi nuk ka kryer asnjë shkelje ligjore, në sajë të së cilës atij do t'i ishte hequr e drejta për t'u zgjedhur në shtetin nga vjen.

- (2) Zgjedhjet e Këshillave të Lagjeve në Graz bëhen të dielën, më 26 shtatorë 2021. Data 16 korrik 2021 vlen si ditë reference.

Për lagjen e I-rë, Innere Stadt, do të zgjidhen 7 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e II-të, St. Leonhard, do të zgjidhen 10 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e III-të, Geidorf, do të zgjidhen 15 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e IV-të, Lend, do të zgjidhen 19 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e V-të, Gries, do të zgjidhen 17 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e VI-të, Jakomini, do të zgjidhen 19 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e VII-të, Liebenau, do të zgjidhen 9 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e VIII-të, St. Peter, do të zgjidhen 10 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e IX-të, Waltendorf, do të zgjidhen 8 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e X-të, Ries, do të zgjidhen 7 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e XI-të, Mariatrost, do të zgjidhen 7 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e XII-të, Andritz, do të zgjidhen 12 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e XIII-të, Gösting, do të zgjidhen 7 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e XIV-të, Eggenberg, do të zgjidhen 12 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e XV-të, Wetzelsdorf, do të zgjidhen 9 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e XVI-të, Straßgang, do të zgjidhen 9 këshilltarë të lagjes.

Për lagjen e XVII-të, Puntigam, do të zgjidhen 7 këshilltarë të lagjes.

Të drejtën për pjesëmarrje në zgjedhjet e Këshillit të Lagjes e kanë banorët e qytetit me të drejtë votimi në zgjedhjet e Këshillit Bashkiak, por vetëm për atë lagje, ku ata kanë vendbanimin e përhershëm dhe nëse figurojnë në listën e zgjedhësve për zgjedhjet e Këshillit Bashkiak.

Për t'u zgjedhur në Këshillin e Lagjes duhen përmbushur kushtet për kandidim në Këshillin Bashkiak (shih paragrafin 1) dhe përveç tyre duhet që kandidati të ketë vendbanimin e përhershëm ose të ushtrijë profesionin në lagjen, ku kandidon.

- (3) Zgjedhjet për Këshillin e Imigranteve/-ëve në Graz do të mbahen të dielën, më 26 shtatorë 2021. Data 16 korrik 2021 konsiderohet si ditë reference.

Në Këshillin e Imigranteve/-ëve do të zgjidhen 9 anëtarë.

Grupet konkurruese zgjedhore duhet t'i paraqesin autoritetit të zgjedhjeve lokale kandidaturat e tyre për Këshillin e Imigranteve/-ëve jo më vonë se 37 ditë para ditës së zgjedhjeve, deri në orën 17.00. Data dhe ora e marrjes në dorëzim do të shënohen në kandidaturën e paraqitur.

Kandidaturën duhet ta nënshkruajë të paktën një anëtar i Këshillit të Imigranteve/-ëve ose ta përkrahin të paktën 10 persona me të drejtë vote, sipas § 100 Rregullorja e Zgjedhjeve Bashkiake Graz 2012, LGBl. 86/2012. Në deklaratën e përkrahjes duhet të shënohen mbiemri dhe emri, datëlindja dhe adresa e banimit të personit me të drejtën e votës. Deklaratat e përkrahjes duhet të firmosen personalisht nga këta persona me të drejtën e votës dhe do t'i bashkangjiten kandidaturës së paraqitur. Tërheqja mbrapsht e një deklaratë përkrahëse, pas dorëzimit të saj pranë autoritetit përkatës të zgjedhjeve lokale është e mundur, vetëm në qoftë se përkrahësi i kandidaturës i paraqet autoritetit të zgjedhjeve lokale prova ose dëshmi bindëse, për të treguar se personi në fjalë ka firmosur gabimisht ose për shkak të një mashtrimi apo kërcënimi.

Kandidatura duhet të përmbajë:

1. emërtimin dallues të grupit konkurrues zgjedhor, shkruar me fjalë të plota sidhe dhe në formë shkurtese, e përbërë nga jo më shumë se pesë germa, e cila mund të ketë po ashtu kuptimin e një fjale më vete;
2. listën e emrave të personave kandidues, e cila përmban jo më shumë se 18 kandidatë, të renditur numerikisht, me të dhënat përkatëse si: mbiemrin dhe emrin, vitin e lindjes, nënshtetësinë, lejen e qëndrimit, profesionin dhe adresën e banimit të përhershëm në Graz për secilin kandidat;
3. të dhënat e personit përfaqësues me të drejtë marrjen e postës në dorëzim (mbiemrin dhe emrin, profesionin, adresën);
4. nënshkrimet ose deklaratat e përkrahjes së nevojshme sipas paragrafit 2;
5. deklaratën me shkrim të secilit kandidat, ku ata pranojnë përfshirjen e tyre në listën e kandidatëve.

Në qoftë se brenda afatit nuk paraqitet asnjë kandidaturë e vlefshme ose nëse gjitha kandidaturat e paraqitura duhet të konsiderohen si të paparaqitura, zgjedhjet nuk mbahen.

Të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhje e kanë të gjithë imigrantet/-ët të cilat/-ët:

- kanë mbushur moshën 16 vjeç, qoftë edhe në ditën, kur zhvillohen zgjedhjet;
- në ditën e referencës nuk figurojnë si të përjashtuar nga e drejta e votimit;
- kanë vendbanimin e tyre të përhershëm në qytetin e Graz-it;
- nuk kanë nënshtetësinë e një shteti anëtar të Bashkimit Europian.

Sipas § 100 Rregullores së Zgjedhjeve Lokale Graz 2012, LGBl. 86/2012 mund të zgjidhen në Këshillin e Imigranteve/-ëve të gjithë personat me të drejtën e votës, të cilat/-ët:

- kanë mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën kur zhvillohen zgjedhjet;
- në ditën e referencës figurojnë me një leje qëndrimi të vlefshme;
- prej jo më pak se gjashtë muajsh kanë vendbanimin e tyre të përhershëm në Graz.

Votimi për zgjedhjet e Këshillit të Imigranteve/-ëve mund të ushtrohet edhe nëpërmjet postimit të votës.

Kryetari i Bashkisë
Mag. Siegfried Nagl